



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Hapet Panairi "Food & Drink Festival 2018"

2018-03-12 11:45:00



ExpoCity Albania në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Qendrën e Eksporteve Shqiptare, sjellë për të tretin vit rradhazi, në datat 9-11 Mars, panairin "Food & Drink Festival 2018".

Qëllimi kryesor i këtij panairi është promovimi i produkteve tipike mesdhetare, shkëmbimi i informacionit dhe njohja me të rejtat më të fundit të industrisë ushqimore. Edicioni i tretë i Panairit "Food & Drink Festival" është konceptuar nën moton "Eat. Drink. Educate", duke ofruar jo vetëm një hapësirë ekspozimi, por dhe konferenca, seminare, trajnime, degustime dhe ambiente festive.

Veçoria e këtij Panairi është se krahas sipërmarrjeve dhe markave më të mëdha të pranishme në tregun shqiptar, marrin pjesë edhe sipërmarrjet e vogla, të specializuara në prodhime shqiptare të traditës.

Kjo është një mënyrë shumë e mirë për të njohur dhe për të promovuar produkte që nuk gjenden lehtësisht në distribucionin e gjerë, siç janë produktet e disa fermave të vogla që kanë prodhime organike cilësore.

Këtë vit do të organizohet edhe Konkursi i Verës, ku do të përzgjidhet vera më cilësore, nga një juri e specializuar.

Në emër të Ministrisë së Bujqësisë, përsëhendeti zëvendësministri z.Dhimo Kote, i cili ndër të tjera përmendi dhe Brandin e rrjetit të dyqaneve me produkte tipike shqiptare "edua".

Në vazhdimësi të kësaj iniciative ai ftoi të gjithë subjektet të marrin të drejtën e përdorimit të këtij brandi pranë Agjencisë së Zhvillimit Rajonal Ekonomik dhe më pas të përgatisin projektet e tyre për ngritjen e dyqaneve me produkte tipike shqiptare, duke u mbështetur me 50% të vlerës së investimit deri në 2 milionë lekë.

"Misioni ynë si Ministri Bujqësie është të vazhdojmë të promovojmë ata që vrapojnë më shpejt, të evidentojmë suksesin dhe t'i mbështesim, por të kemi marrëdhënie serioze me shtetet serioze, të cilët sjellin produkte në vendin tonë. Pra, ne do të funksionojmë si një zinxhir, duke qenë pjesë e Komunitetit Evropian." tha z.Kote.

Ne kete panair eshte perfaqesuar me stende edhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit i cili në thelbin e tij të punës ka ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e operatorëve të biznesit dhe garantimin e sigurisë ushqimore për konsumatorët.